



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. Br Prot. 01-4514/13
Nr. l. pag. Broj. stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 30.12.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.12.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-2509\13, për zyrtarin e lartë z. Bislim Bislimi, u.d, i Drejtorit të Klinikës së Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej pasi që ka dhen dorëheqje nga pozita e zyrtarit të lartë .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-2509/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin i lartë, z. Bislim Bislimi, u.d, i Drejtorit të Klinikës së Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si u.d, i Drejtorit të Klinikës së Biokimisë në (QKUK), cili është duke ushtruar edhe një funksion në bizneset e tij private "N.T.SH BIOCYT" dhe "TIRANA LAB -sh.p.k", e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.09.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar

procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Bislim Bislimi, u.d, i Drejtorit të Klinikës së Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë, ka kërkuar që ti behët një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e agjencisë gjatë takimit që kanë mbajtur me zyrtarin në fjale e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, në ushtrim të funksionit publik, zyrtari në fjalë pasi që ka marrë edhe informatat në mënyrë verbale, është pajtuar për situatën në të cilën ndodhet dhe është zotuar se do të jap dorëheqje nga pozita e u.d. të Drejtorit pasi që e ushtron këtë pozitë vetëm me insistimin e menaxhmentit të QKUK-së, dhe nuk është i interesuar të mbaj pozitën e zyrtarit të lartë.

Zyrtari i lartë, z. Bislim Bislimi, u.d, i Drejtorit të Klinikës së Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, pas kësaj ka sjellë deklaratën e dorëheqjes nga pozita e i Drejtorit të Klinikës së Biokimisë, ndërsa Agjencia ka pranuar njoftimin dhe vendimin e QKUK-së ku dëshmohet miratimi i dorëheqjes së z. Bislim Bislimi dhe emërimi i një zyrtari të ri në pozitën e u.d. të Drejtorit të Klinikës së Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Andaj konsiderojmë se zyrtari i lartë z. Bislim Bislimi, u.d, i Drejtorit të Klinikës së Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). ka dhënë dorëheqje dhe nuk e ushtron më pozitën e zyrtarit të lartë, dhe dëshmojë se ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

